



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT**

Seksioni për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202002594/2

Tiranë ___/___/2020

Lënda: Rekomandim legjislativ për miratimin e ndryshimeve të nevojshme në Kodin e Familjes, për parandalimin e martesave të hershme dhe mbrojtjen e fëmijëve prej tyre.

MINISTRISË SË DREJTËSISË

MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

AGJENCISË SHTETËRORE PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE

TË FËMIJËS

TIRANË

Të nderuar,

Institucioni i Avokatit të Popullit është vënë në dijeni nga mediat *online*, lidhur me fenomenin e martesave të vajzave të mitura në vendin tonë¹. Por këtë fenomen tejet shqetësues e kemi ndeshur dhe më parë, pasi evidentohet në mediat online, ndaj në mbështetje të nenit 13, të ligjit nr.8454, datë 4.2.1999 "Për Avokatin e Popullit", të ndryshuar, Avokati i Popullit filloi procedurën e shqyrtimit të çështjes "*ex-officio*" për rastin në fjalë.

Martesa e vajzave nën moshën 18 vjeç mbetet një fenomen shqetësues dhe referuar të dhënave nga INSTAT. Gjatë vitit 2019, gjykatat shqiptare kanë

¹Artikulli nga www.shqiptarja.com, "Skandal/Gjykatat martuan 20 vajza të mitura në 2019, shfrytëzuan një hapësirë në Kodin e Familjes".

lejuar martesën e 20 vajzave të mitura, pra nën 18 vjeç, ndërkohë që në vitin 2018, ky numër ka qenë 24.

Duke ju referuar disa të dhënave të INSTAT, në botimin “Burrat dhe gratë në Shqipëri”², janë 10 vajza të martuara nën moshën 18 vjeç për çdo 1000 martesë. Në total, grupmosha “nën 19 vjeç” përbën 17.4 % të totalit të martesave. Situata është krejtësisht e kundërt për djemtë e të njëjtës grupmoshë³.

Ligji nr.9062, datë 8.5.2003 “Kodi i Familjes në RSH” i ndryshuar, në pikën 1, të nenit 7, ndalon martesën nën moshë. Ndërkohë, që pika 2 e këtij neni, është referenca ligjore në shumicën e rasteve, mbi të cilën gjykatat kanë lejuar martesat nën moshën 18 vjeç⁴.

Martesa e hershme ose martesë e fëmijëve është bashkimi zyrtar ose jo, i dy personave, kur të paktën, një prej tyre është nën 18 vjeç. Për shkak të të qenit fëmijë, “bashkëshortët fëmijë” konsiderohen të jenë të paafte për të dhënë pëlqimin e plotë, që do të thotë që martesat e fëmijëve duhet të konsiderohen shkelje e të drejtave të njeriut dhe të drejtave të fëmijës.

Avokati i Popullit e inicioi këtë rast me iniciativë, në përvijim të të gjitha përpjekjeve, edhe në aspektin ndërkombëtar, për të parandaluar martesat në moshë të hershme. Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës ka rekomanduar⁵, që kufiri i ulët i moshës për martesë të rritet në moshën 18 vjeç, si për vajzat ashtu edhe për djemtë, pavarësisht nëse prindërit e tyre, kanë dhënë pëlqimin e tyre për martesë. Martesa e fëmijëve është një nga shkeljet ekstreme të të drejtave të fëmijëve dhe një formë serioze e abuzimit të fëmijëve. Ajo u mohon fëmijërinë, mirëqenien dhe potencialin e tyre. Të qenit i martuar, i detyron vajzat për marrëdhënie fizike dhe emocionale, në moshë shumë të re, të hershme, për të cilat nuk janë të gatshme. Përpjekjet për t’i dhënë fund martesës së fëmijëve duhet të synojnë në veprime të koordinuara në arsim, shëndetësi, mbrojtje dhe sektorë të tjerë.

Një numër i konsiderueshëm dokumentesh ndërkombëtarë, si marrëveshje e konventa ndërkombëtare dhe rajonale për të drejtat e njeriut⁶, e po ashtu, edhe

² http://www.instat.gov.al/media/1143/burrat_dhe_grat__ne_shqiperi_2017_libri.pdf

³ Në po të njëjtin raport, INSTAT ka informuar se “nuk ka martesë për djemtë para moshës 18 vjeç, si dhe përqindja e djemve të martuar 18-19 vjeç është e papërfillshme.

⁴ Pika 2, e nenit 7, të Kodit të Familjes parasheh se: “...**Gjykata e vendit ku lidhet martesë, për shkak me rëndësi, mund të lejojë martesën edhe përpara kësaj moshe...**”.

⁵ CRC Committee’s General Comment No. 4.

⁶ Ndër më kryesoret janë Konventa mbi Pëlqimin për Martesë, Moshën Minimale për Martesë dhe Regjistrimin e Martesave; Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Grave, si dhe Konventa për të Drejtat e Fëmijëve.

programe të ndryshme ndërkombëtare për veprim, e cilësojnë martesën e fëmijëve, si një shkelje të të drejtave të njeriut në dëm të të drejtave të vajzave dhe grave për shëndetin, arsimin dhe për të jetuar të lirë nga dhuna.

Agjenda 2030 për Zhvillimin e Qëndrueshëm dhe 17 Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG), të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, përbëjnë një shtysë të re në përpjekjet globale, për të arritur një zhvillim të qëndrueshëm dhe, synojnë të trajtojnë sfidat globale, si varfëria, pabarazia dhe ndryshimet klimatike, si dhe të përmirësojnë qasjen në shëndetësi dhe arsim, të ndërtojnë institucione dhe partneritete të forta. Objektivi nr.5 i Agjendës së Kombeve të Bashkuara për Zhvillim të Qëndrueshëm synon eliminimin e të gjitha praktikave të dëmshme, të tilla si martesat e hershme e fëmijëve dhe e detyruar.

Duke u mbështetur në faktin se janë fëmijë, fëmijët e martuar konsiderohen si të paaftë për të dhënë pëlqimin e plotë, që do të thotë se martesat e fëmijëve duhet të konsiderohen absolutisht, si një shkelje e të drejtave të njeriut dhe të drejtave të fëmijëve. Normat e martesës së fëmijëve janë të ulëta në Shqipëri, por ato hasen si praktika, në mes të Komunitetit Rom dhe në disa zona të izoluara rurale. Martesa e fëmijëve është një fenomen gjinor që prek vajzat dhe djemtë në mënyra të ndryshme. Në përgjithësi, numri i djemve në martesat e hershme në mbarë botën, është dukshëm më i ulët se ai i vajzave. Ndërsa, fëmijët-vajza të martuara janë të prekura edhe nga dhuna në familje dhe abuzimi seksual brenda marrëdhënieve të pabarabarta dhe, nëse janë shtatzëna, shpesh kalojnë ndërlikime gjatë shtatzënisë dhe lindjes, pasi trupat e tyre nuk janë të gatshme për të lindur fëmijë⁷.

Kuadri ligjor në vendin tonë

Martesat e hershme përbëjnë cenim dhe shkelje të të drejtave të fëmijëve, përfshirë këtu, të drejtën për barazi, bazuar tek seksi dhe mosha, të drejtën për edukim dhe zhvillim, të drejtën për t'u martuar dhe krijuar një familje, të drejtën për të jetuar, të drejtën për të patur një standard të mundshëm të mirëqënies. Është shumë e rëndësishme për një vend që të përfshijë në legjislacionin përcaktimin konkret të moshës minimale për martesë. Harmonizimi i legjislacionit kombëtar me standardet dhe kërkesat ndërkombëtare, është një nga angazhimet e ndërmarra nga qeveria, përmes ratifikimit të disa konventave ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe,

⁷<https://albania.unfpa.org/sq/publications/martesat-e-f%C3%ABmij%C3%ABve-n%C3%AB-shqip%C3%ABri>

veçanërisht i konventave, që adresojnë në mënyrë specifike të drejtat e grave dhe vajzave.

Kushtetuta e RSH-së parasheh se “...kushdo ka të drejtë të martohet dhe të ketë familje...”, si dhe “...martesa dhe familja gëzojnë mbrojtjen e veçantë të shtetit...”⁸. Fëmijët, të rinjtë, gratë shtatzëna dhe nënat e reja kanë të drejtën e një mbrojtjeje të veçantë nga shteti⁹. Këtë përcaktim të ligjit themelor të shtetit, si dhe përcaktimin se “...lidhja dhe zgjidhja e martesës rregullohen me ligj...”¹⁰, Kodi i Familjes i RSH-së¹¹ e ka përçuar me parashikimin se “...Prindërit, organet kompetente dhe gjykatat, në vendimet dhe veprimtarinë e tyre, duhet të kenë si konsideratë parësore interesin më të lartë të fëmijës...”¹². Rëndësi thelbësore i jepet dhënies së pëlqimit për martesë¹³.

Sipas Kodit të Familjes, mosha minimale ligjore për martesë në Shqipëri është 18 vjeç. Megjithatë, i njëjti nen i Kodit të Familjes ka përcaktuar gjithashtu, se gjykata mund të miratojë martesën në një moshë më të hershme “për çështje me rëndësi”.

Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë ka parashikuar, se një person arrin zotësinë e plotë për të vepruar kur ai ose ajo arrin 18 vjeç¹⁴. Kodi specifikon, megjithatë, se nëse një vajzë martohet para moshës 18 vjeç, ajo automatikisht fiton (arrin) zotësinë për të vepruar. Përveç kufirit të moshës për martesë, legjislacioni shqiptar nuk përcakton asnjë masë për të parandaluar martesat e fëmijëve.

Martesa e fëmijëve në Shqipëri është një çështje komplekse. Shpesh të rinjtë e prekur nga martesa e fëmijëve përfshihen në një cikël varfërie, shfrytëzimi dhe marginalizimi. Si dukuri, ajo është trajtuar në kontekste të tilla si: përjashtimi social me bazë etnike, diskriminimi, varfëria, puna e fëmijëve dhe shfrytëzimi. Vlen të theksohet fakti, se martesat që përfshijnë fëmijë nuk regjistrohen, ndaj nuk ka të dhëna të sakta statistikore mbi këtë fenomen. Ka një kosto të madhe për mosveprimin në martesat e fëmijëve, pasi ky fenomen u mophon atyre fëmijërinë, arsimin, vë në rrezik shëndetin e tyre dhe kufizon mundësitë e tyre për zhvillimin normal. Për asnjë arsye, qoftë ekonomike apo kulturore, nuk mund të përliqet dëmi, që këto martesa u shkaktojnë, jo vetëm

⁸ Neni 53 i Kushtetutës së RSH-së

⁹ Neni 54 i Kushtetutës së RSH-së

¹⁰ Neni 53/3

¹¹ Ligji nr.9062, datë 8.5.2003, i ndryshuar.

¹² Neni 2

¹³ Neni 8 i KF, parasheh se “Martesa lidhet para nëpunësit të gjendjes civile, me pëlqimin e lirë të dy bashkëshortëve të ardhshëm”.

¹⁴ Neni 6

në aspektin emocional, shpirtëror e mendor, por edhe fizik, vajzave të reja dhe mundësive që ato kanë për një të ardhme ndryshe. Përmendim vajzat, pasi janë ato që preken më së shumti nga ky fenomen. Vajzat e martuara kanë nevojë për strategji të posaçme, të synuara, që sigurojnë akses në arsim, aftësi jetësore, shëndet dhe mundësi për të marrë pjesë plotësisht në shoqëri.

Legjislacioni shqiptar parashikon martesë nën moshën 18 vjeç për raste të veçanta, me vendim gjykate, duke ja lënë kështu gjyqësorit të çmojë dhe interpretojë në këtë rast, se kur do të cilësohet një rast si “rasti i veçantë”. Gjyqtarët edhe në këtë paqartësi ligjore, kanë mundësi t’i ndalojnë martesat e hershme, duke marrë parasysh përkufizimin e tyre në konventat ndërkombëtare. Ndaj, është e rëndësishme të theksohet, se gjyqtarët duhet të analizojnë në të gjitha planet parimin e interesit më të lartë të fëmijës në procesin e marrjes së vendimit për lejimin e martesave të hershme. Në përcaktimin e “interesit më të lartë të të miturit”¹⁵, duhet të merren parasysh të gjitha të drejtat ligjore të fëmijës, si dhe çdo rrethanë individuale. Përcaktimi i interesit më të lartë duhet të përfshijë pjesëmarrjen e fëmijëve në proces pa asnjë diskriminim, peshën e duhur që duhet t’u jepet pikëpamjeve të fëmijës, si dhe më kryesorja, zbatimin e vlerësimit të ndikimit, që politikat publike dhe politikbërësit, me vendimmarrjen e tyre kanë tek të drejtat e fëmijëve (CRIA).

Kuadri ligjor ndërkombëtar që adreson martesat e hershme

Martesat e hershme përbëjnë një problem që prek vendet, kulturat dhe etnitë, andaj konsiderohen nga të gjitha konventat për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, si dhunë me bazë gjinore dhe shkelje e të drejtave të tyre.

Konventa për të Drejtat e Fëmijës (KDF) nuk e ndalon në mënyrë të shprehur martesën e fëmijëve, por e ka ndërlidhur përveç të tjerash, me të drejtën e shprehjes së lirë, të mbrojtjes nga dhuna e abuzimi, të mbrojtjes nga praktikrat e dëmshme e tradicionale. Fëmija përcaktohet “..si çdo qenie njerëzore nën moshën 18 vjeç, përveç nëse, sipas ligjit të zbatueshëm për fëmijën, moshë madhore është arritur më herët...”. Gjithsesi, megjithë mungesën e referimit në KDF, Komiteti i OKB-së për të Drejtat e Fëmijës ka përcaktuar, se moshë minimale për martesë duhet të jetë për vajzat si dhe për djemtë, moshë 18 vjeç. Dispozitat e kësaj konvente përshkohen nga parimi i interesit më të lartë

¹⁵Komiteti për të Drejtat e Fëmijës, Komenti i Përgjithshëm Nr. 14 “Mbi të drejtën e fëmijës që interesat e tij/saj më të lartë të merren si një konsideratë parësore, 2013, CRC / C / GC / 14.

të fëmijës, ndaj dhe në institutin e martesës ky parim prevalon. Pra, duke patur si konsideratë parësore interesin më të lartë të fëmijës, martesat e tyre nuk mund të jenë aspak në përmbushje të këtij parimi. Po kështu, përveç këtij parimi, KDF parasheh në disa nga nenet e saj mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në rrezik nga martesat¹⁶. Ajo mund të konsiderohet si një formë e diskriminimit të bazuar në gjini, pasi më së shumti janë vajzat ato që preken nga ky fenomen. Ndaj, në përgjigje të këtij fenomeni, përcaktohet detyrimi, që shtetet palë kanë për marrjen e të gjitha masave të efektshme dhe të nevojshme, për të zhdukur praktikat tradicionale, të dëmshme për shëndetin e fëmijëve¹⁷. Komiteti i OKB për të Drejtat e Fëmijëve ka rekomanduar, që dukurisë së martesës së fëmijëve, i duhet qasur me parimin e interesit më të lartë të fëmijës, duke kërkuar edhe mbrojtjen e të drejtave për shprehjen e lirë, lirisë nga dhuna e abuzimi, si dhe nga praktikat tradicionale të dëmshme. Ky komitet i rekomandon shteteve palë të rishikojnë dhe, kur është e nevojshme, të reformojnë legjislacionin dhe praktikën e tyre, për të rritur moshën minimale në 18 vjeç për martesë me dhe pa pëlqimin e prindërve, si për vajzat, ashtu dhe për djemtë¹⁸.

Rekomandimi i Përgjithshëm nr.31, i Komitetit për Eleminimin e Diskriminimit ndaj Grave, si dhe Komenti i Përgjithshëm nr.18, i Komitetit për të Drejtat e Fëmijës, për praktikën e dëmshme kanë përcaktuar se: “...Martesa e fëmijëve, gjithashtu referuar si martesë e hershme, është çdo martesë ku të paktën njëra nga palët është nën moshën 18 vjeç. Martesa e fëmijëve konsiderohet të jetë një formë e martesës së detyruar, duke pasur parasysh që njëra dhe/ose të dy palët nuk kanë shprehur pëlqim të plotë, të lirë dhe të informuar...”.

Rekomandimi i Përgjithshëm nr.21, i Komitetit CEDAW, gjithashtu, përcakton, se e drejta e gruas për të zgjedhur bashkëshortin dhe për t’u lidhur lirisht në martesë është thelbësore për jetën e saj, për dinjitetin dhe barazinë e saj si një njeri.

¹⁶ Nenet 2, 13, 24 dhe 28 të KDF

¹⁷ Neni 24/3

¹⁸ Komenti i Përgjithshëm nr.4 i Komitetit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës (2003) “Shëndeti dhe zhvillimi i adoleshentëve në kontekstin e KDF” CRC/GC/2003/4. Po ashtu Komiteti i OKB për të Drejtat e Fëmijëve, në vitin 2016, ka vijuar me thirrjen për shtetet, që të sanksionojnë detyrimin që personat deri në moshën 18 vjeç kanë të drejtën e mbrojtjes së vazhdueshme nga të gjitha format e shfrytëzimit dhe abuzimit, duke kërkuar që kufiri minimal i moshës për martesë duhet të jetë 18 vjeç. Komenti i Përgjithshëm nr.20 “Mbi zbatimin e të drejtave të fëmijës gjatë adoleshencës”CRC/C/GC/20, pika 40.

Në rekomandimin/komentin e përbashkët të dy komiteteve të Kombeve të Bashkuara¹⁹ theksohet, se martesë e fëmijëve shoqërohet shumë shpesh me shtatëzani të hershme dhe me lindje të hershme të fëmijëve. Gjithashtu, martesë e fëmijëve kontribuon në shtimin e përqindjes së braktisjes së shkollimit, veçanërisht në mesin e vajzave, largimit me forcë nga shkolla dhe rrezikut të shtuar të dhunës në familje, përveç kufizimit të gëzimit të së drejtës për liri të lëvizjes.

Konventa për Eleminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW), si një “Magna-Karta liberatum” për të drejtat e grave, garanton përgjegjësinë e shtetit për t’i siguruar këto të drejta, të cilat në themel janë të drejta të njeriut. Dispozitat e CEDAW në lidhje me martesën e fëmijëve, parashikojnë se burrat dhe gratë kanë të njëjtën të drejtë për të lidhur martesë, kanë të njëjtën të drejtë për të zgjedhur lirisht bashkëshortin dhe të martohen vetëm me vullnetin e tyre të lirë dhe pëlqim të plotë, si dhe fejesa dhe martesë e një fëmije nuk do të kenë asnjë efekt juridik²⁰.

Në vitin 2012, Komiteti i CEDAW si dhe Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB kundër Dhunës ndaj Fëmijëve, i kanë bërë thirrje shteteve, që të rrisin pa përjashtim moshën për martesë në 18 vjeç për vajzat dhe për djemtë, duke deklaruar gjithashtu, se martesë e fëmijëve nuk mund të justifikohet për arsye tradicionale, fetare, kulturore ose ekonomike²¹.

Mosha minimale për martesë duhet të jetë 18 vjeç, si për vajzat dhe për djemtë. Kur ata martohen, ata marrin përgjegjësi të rëndësishme. Për rrjedhojë, martesë nuk duhet të lejohet, përpara se të kenë arritur pjekurinë e plotë dhe zotësinë për të vepruar. Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë, kur të miturit, veçanërisht vajzat, martohen dhe kanë fëmijë, shëndeti i tyre mund të ndikohet negativisht dhe të pengohet arsimimi i tyre. Si rezultat, autonomia e tyre ekonomike është e kufizuar²².

¹⁹Komiteti për Eleminimin e Diskriminimit ndaj Grave CEDAW dhe Komiteti për të Drejtat e Fëmijëve CRC “Joint general recommendation no.31 of the CEDAW Committee/General Comment no.18 of the CRC on harmful practices, 14 november 2014”.

²⁰Neni 16 (1): Shtetet Palë do të marrin të gjitha masat e duhura për të eliminuar diskriminimin ndaj grave në të gjitha çështjet që lidhen me martesën dhe marrëdhëniet familjare dhe në veçanti do të sigurojnë, mbi bazën e barazisë së burrave dhe grave: (a) të drejta të njëjtë për lidhjen e martesës; (b) E drejta e njëjtë për të zgjedhur bashkëshortin dhe për të lidhur martesë vetëm me pëlqimin e tyre të lirë dhe të plotë Neni 16 (2): Fejesa dhe martesë e një fëmije nuk do të kenë efekt juridik dhe të gjitha veprimet e nevojshme, përfshirë legjislacionin, do të merren për të specifikuar një moshë minimale për martesë dhe për ta bërë të detyrueshëm regjistrimin e martesave në një regjistër zyrtar.

²¹Raport i Zyrës së Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut “Parandalimi dhe eliminimi i martesave të hershme dhe të detyruara të fëmijëve”, A/HRC/26/22, 2 prill 2014.

²² Komiteti i CEDAW, pika 36, Rekomandimet e përgjithshme 21.

Mund të themi që dy konventat, Konventa për të Drejtat e Fëmijës dhe Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW), në kontekstin e barazisë, plotësojnë njëra-tjetrën, duke konkluduar, se martesat e hershme shkelin të drejtën e vajzave për barazi në bazë të gjinisë. CEDAW vendos detyrimin për shtetet, që të ndërmarrin të gjitha masat e duhura, përfshirë legjislacionin, për të siguruar zhvillimin dhe përparimin e plotë të grave, me qëllim që t'u garantohet atyre gëzimi dhe ushtrimin i të drejtave të njeriut dhe lirive themelore në bazë të barazisë me burrat. Të dy komitetet, përmes jurisprudencës së tyre lidhur me martesën e fëmijëve, theksojnë tiparet plotësuese dhe reciprokisht përforcuese të të dy Konventave, sa i përket moshës së martesës. Ndërsa, KDF, megjithëse nuk ndalon posaçërisht martesën e fëmijëve, në mënyrë të qartë përcakton moshën madhore 18 vjeç, si mosha e lejuar për martesë. CEDAW e konsideron martesën e fëmijëve të pavlefshme qysh prej fillimi.

Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës u ka kërkuar parlamenteve kombëtare të vendeve anëtare të Këshillit të Evropës, që të përshtasin legjislacionet e tyre, me qëllim rritjen deri në 18 vjeç të moshës minimale ligjore të martesës për femrat dhe meshkujt²³. Ndërsa, Parlamenti Evropian në rezolutën e miratuar në korrik 2019, rekomandon qartësisht ndalimin e këtyre martesave. Rezoluta e Parlamentit Evropian, e korrikut të këtij viti, kërkon nga shtetet anëtare të BE-së, si edhe për vendet me të cilat bashkëpunojnë, të ndalojnë me ligj martesat e fëmijëve, martesat e hershme dhe ato të detyruara²⁴.

Por kjo nuk i ka penguar aspak disa vende, përfshirë dhe Shqipërinë, ndonëse si rast përjashtimor, ta lejojnë martesat nën moshën 18 vjeç me vendim gjykatë. Shpesh, është rekomanduar forcimi i kriterëve për lejimin e martesave të hershme dhe monitorimi i tyre nga strukturat vendore. Martesat në moshë të hershme përsërisin ciklin e varfërisë, pasi fëmija largohet nga shkolla, komuniteti ku zhvillon dijet, duke kufizuar në mjaft raste mundësitë e aftësimit për punë më tej, e në këtë mënyrë ndikon negativisht në mirëqenien e zhvillimin normal të tij/saj.

Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara ka miratuar një numër të konsiderueshëm rezolutash për martesën e hershme dhe të detyruar të fëmijëve²⁵. Më 17 nëntor 2011, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara miratoi një rezolutë (A/RES/66/170), që përcaktoi 11 tetorin si

²³Rezoluta 1468 (2005) "Mbi martesat e detyruara dhe martesat e fëmijëve".

²⁴Rezoluta nënvizon se konsiderohen mangësi ligjore në ato raste, kur martesa e fëmijëve lejohet, kur përdhuesve, abuzuesve të fëmijëve, atyre që i rrëmbejnë, i trafikojnë, apo i skllavërojnë, u krijohet mundësia që t'i shpëtojnë dënimit, në qoftë se martohen me viktimën e tyre.

²⁵Rezolutat 69/156 (2014); 71/175 (2016) dhe 3/73 (2018)

“Dita Ndërkombëtare e Fëmijës Vajzë” dhe, që zgjodhi si temën e ditës, në ditën e parë ndërkombëtare të fëmijës-vajzë, temën e dhënies fund të martesave të fëmijëve.

Ndaj, Kombet e Bashkuara “nxitin” shtetet anëtare të miratojnë dhe zbatojnë me përpikmëri legjislacionin, për të siguruar, që martesat të lidhen vetëm me pëlqimin e lirë dhe të plotë të bashkëshortëve dhe të miratojnë dhe zbatojnë me përpikmëri ligjet, në lidhje me moshën minimale ligjore të pëlqimit dhe moshën minimale për martesë, si dhe për të rritur moshën minimale për martesë, kur është e nevojshme²⁶.

Organizata Botërore e Shëndetësisë, në vitin 2011, miratoi një udhëzues të saj²⁷ “Mbi parandalimin e shtatzënisë së hershme dhe treguesit e ulët të riprodhimit tek adoleshentët në vendet në zhvillim”, ku ndërmjet gjashtë rekomandimeve të dhëna, njëri prej tyre i dedikohet pikërisht, parandalimit të martesave nën moshën 18 vjeç. Aspektet që paraqet ky dokument, lidhur me parandalimin e martesave në moshë të hershme, janë:

- për ndalimin e martesave të hershme, u bëhet thirrje politikbërësve, që të hartojnë e zbatojnë legjislacion, që ndalon martesat para moshës 18 vjeç;
- arsimimi i vajzave, si një element parësor, që ndikon pozitivisht në shëndetin e tyre dhe, gjithashtu zvogëlon mundësinë e martesave të hershme;
- domosdoshmëria për të punuar me të gjithë aktorët, për të sfiduar dhe ndryshuar normat kulturore rreth martesave në moshë të hershme.

Po kështu, ky udhëzues përmban edhe fushat ku duhen fokusuar përpjekjet, si: ndërhyrjet për përmirësim legjislacioni e politikash shtetërore për mbrojtjen e fëmijëve nga martesat e hershme, ndërgjegjësimi lidhur me lidhjen e ngushtë mes programeve të mbështetjes e fuqizimit ekonomik dhe rritjes së kufirit moshor për lidhjen e martesave, përmirësim i metodikës së vlerësimit të ndikimit të arsimimit dhe regjistrimit në shkollë në moshën e

²⁶www.un.org/esa/population/cpd United Nations Commission on Population and Development, 2012

²⁷“Preventing early pregnancy and poor reproductive outcomes among adolescents in developing countries”https://www.who.int/maternal_child_adolescent/documents/preventing_early_pregnancy/en/

martesës, si dhe informimi e fuqizimi i familjeve dhe të rinjve lidhur me pasojat e këtij fenomeni në jetën e tyre.

Veprimet për t'i dhënë fund martesës së fëmijëve, martesave në moshë të hershme dhe të detyruara janë rritur në nivel ndërkombëtar, rajonal dhe kombëtar²⁸. Evidente është ndërlidhja me zbatimin dhe monitorimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG), veçanërisht nën objektivin 5.3²⁹. Gjithsesi, ky fenomen është i shtrirë në shkallë globale dhe, i gjithë korpusi i marrëveshjeve apo traktateve ndërkombëtare, e kanë adresuar si dukuri, për të cilin duhen ndërmarrë masa të posaçme.

Disa përfundime dhe rekomandime për Shqipërinë

Avokati i Popullit dhe Komisioneri për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve e konsiderojnë një çështje tejet të rëndësishme për ta sjellë në vëmendjen e autoriteteve shtetërore këtë fenomen që prek fëmijërinë.

Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës³⁰, i ka rekomanduar Shqipërisë që të hartojë procedura dhe kritere, jo vetëm për përcaktimin e interesit më të lartë të fëmijës në çdo fushë, por edhe të zbrërthimit të tij në praktikë, si dhe të informohen për to institucionet e kujdesit social (publik dhe privat), gjykatat, autoritetet administrative dhe parlamenti. Arsyeimi ligjor në të gjitha proceset gjyqësore dhe administrative, si dhe vendimet e tyre duhet të bazohet mbi këtë parim³¹. Për këtë, është e nevojshme, që në rastet e martesave të hershme, të merren masa për monitorimin nga institucionet shtetërore në nivel vendor për problemet

²⁸https://ap.ohchr.org/documents/dpage_e.aspx?si=A/HRC/RES/24/23, 27.9.2013 “Strengthening efforts to prevent and eliminate child, early and forced marriage: challenges, achievements, best practices and implementation gaps;

https://ap.ohchr.org/documents/dpage_e.aspx?si=A/HRC/26/22, 2.4.2014 “Preventing and eliminating child, early and forced marriage-Report of the Office of the United Nations High Commissioner for Human Rights A/HRC/26/22; Report for strengthening effort to prevent and eliminate child, early and forced marriage - A/HRC/29/L.15; Report of the Office of the United Nations High Commissioner for Human Rights United Nations on Summary report on the panel discussion on preventing and eliminating child, early and forced marriage (18 July 2014) – A/HRC/27/34; Report of the Secretary-General on Child, early and forced marriage (29 July 2016) - A/71/253; Summary Report of the High Commissioner for Human Rights on Expert workshop on the impact of existing strategies and initiatives to address child, early and forced marriage (March 2017) - A/HRC/35.

²⁹Për të eliminuar të gjitha praktikat e dëmshme, të tilla si martesat e hershme dhe të detyruara të fëmijëve dhe gjymtimet gjentile të grave.

³⁰CRC/C/ALB/CO/2-4 Vëzhgimet përfundimtare për Shqipërinë pas raportit periodik për KDF, 17 shtator-5 tetor 2012.

³¹ Rekomandimi 30/c.

thelbësore siç janë punësimi dhe arsimimi i vajzave të martuara nën moshën 18 vjeç.³²

GREVIO, (Trupa e Pavarur e Ekspertëve Përgjegjës për Monitorimin e Zbatimit të Konventës së Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftën e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje-Konventa e Stambollit) në raportin mbi zbatimin nga Shqipëria të Konventës së Stambollit³³, i nxit autoritetet shqiptare të sigurojnë mbledhjen dhe publikimin e të dhënave në aspektin e të drejtës civile, për numrin e urdhrave të mbrojtjes, seksin, moshën dhe marrëdhëniet e të gjitha palëve të përfshira, si dhe autorizimet e dhëna nga gjykatat për martesat e të miturve³⁴. GREVIO nxit autoritetet të rishikojnë legjislacionin në fuqi, me qëllim vendosjen e masave mbrojtëse shtesë të përshtatshme, siç është kushti i moshës minimale, që i mituri të jetë i aftë të kërkojë autorizim për t'u martuar, të hartojnë udhëzime që përkufizojnë shqyrtimin gjyqësor të çdo kërkesë të të miturit, i cili kërkon autorizim për të lidhur martesë, si dhe nëpunësit gjyqësorë të trajnohen siç duhet, e të sigurojnë, që çdo shqyrtim i tillë të kryhet në bashkëpunim të ngushtë, ndërmjet gjykatave dhe mekanizmave ekzistues për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve (siç janë njësitë e mbrojtjes së fëmijëve të krijuara në nivel vendor). Këto masa duhet të ndërmerren njëkohësisht me përpjekjet për të rritur ndërgjegjësimin për këtë formë dhune, e cila në fakt kërkon edhe angazhimin e profesionistëve të caktuar në masa parandaluese³⁵.

Komiteti CEDAW i ka rekomanduar Shqipërisë³⁶, që të vazhdojë përpjekjet për ndalimin e të gjitha praktikave të dëmshme, përfshirë martesën e fëmijëve³⁷, praktikën e familjeve që zgjedhin burrat, për krime të tjera të kryera në emër të të ashtuquajturit “nder”, dhe ndjekjen penale e ndëshkimin e duhur të autorëve të praktikave të tilla. Po ashtu, të ndalojë rreptësisht martesën e fëmijëve, duke lejuar vetëm përjashtime shumë të kufizuara dhe të përcaktuara qartë, kur gjykatat mund të autorizojnë martesat nën moshën

³²“Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës i ka rekomanduar Shqipërisë, marrjen e masave për zbatimin e plotë të kufirit të moshës për martesat dhe marrjen e masave të nevojshme për të frenuar praktikën e dëmshme të martesave të hershme dhe të detyruara, duke përfshirë zhvillimin e programeve të sensibilizimit e ndërgjegjësimin dhe, fushata që përfshijnë drejtues të komuniteteve, shoqërinë në përgjithësi dhe vetë fëmijët, mbi ndikimin negativ të martesave të hershme dhe të detyruara”. Pika 48 e Rekomandimeve të Komitetit të OKB për të Drejtat e Fëmijëve, viti 2012.

³³Në nëntor 2017

³⁴ Pika 44. 12 Tetor 2017, Raporti i GREVIO-s për masat legjislative në zbatim të Konventës së Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje.

³⁵Paragrafi 42/a i konkluzioneve përfundimtare të raportit të katërt periodik për Shqipërinë, Komiteti CEDAW, 2016

³⁶https://tbinternet.ohchr.org/_layouts/15/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolno=CEDAW/C/ALB/CO/4&Lang=En Concluding observations on the fourth periodic report of Albania.

³⁷ Pika 21 e rekomandimeve.

18 vjeç me pëlqimin e të dy partnerëve, dhe të rrisin ndërgjegjësimin tek fëmijët, prindërit, komuniteti dhe fetarët drejtuesit dhe publiku i gjerë i ndikimit negativ të martesave të fëmijëve në shëndetin dhe zhvillimin e fëmijëve, në veçanti të vajzave³⁸.

Një nga organizatat më të spikatura të shoqërisë civile³⁹, me të cilën institucioni i Avokatit të Popullit ka bashkëpunuar, kryesisht në kontekstin e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, ka bërë përpjekje për evidentimin e këtij fenomeni në shoqërinë shqiptare. Njëpërmjet studimit “Martesat e hershme në Shqipëri – fokusi mbi Komunitetin Rom”⁴⁰, janë evidentuar se të dhënat cilësore, në lidhje me martesat e hershme janë të kufizuara në vendin tonë⁴¹. Martesa e hershme është përhapur dhe mund të çojë në një jetë me disavantazh dhe privim⁴².

Në ushtrimin e veprimtarisë sonë administrative, e kemi ndeshur këtë dukuri të ndërthurur me problemin e mosregjistrimit në gjendjen civile të fëmijëve, të gjendjes së vështirë e pa mbështetje ekonomike, kryesisht nga pjesëtarë të komunitetit Rom ose që jetojnë në zonat e thella rurale. Për më tepër, gjatë këtij viti, nisur dhe nga mbrojtja e interesit më të lartë të fëmijës, kemi trajtuar me iniciativë gjendjen e vështirë dhe situatën komplekse të dy të miturve (përkatësisht 13 dhe 16 vjeç), të bërë prindër të një foshnjeje⁴³. Rasti, pavarësisht trajtimit dhe mbështetjes së strukturave vendore për dy të miturit e bërë prindër, vë në dukje rëndësinë që merr ndërgjegjësimi i mbarë shoqërisë, që fuqizimi dhe mbështetja ekonomike e familjeve në nevojë, më së shumti ndihmon në parandalimin e këtij fenomeni. Institucioni i Avokatit të Popullit, në ushtrim të mandatit të tij kushtetues, për parandalimin e shkeljes, mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut, në situatën kritike të fatkeqësisë natyrore të shkaktuar nga pandemia Covid-19, ka ndjekur dhe vazhdon të ndjekë me një vëmendje të posaçme, gjendjen e komuniteteve

³⁸ Pika 42/b

³⁹ Observatori për të Drejtat e Fëmijëve

⁴⁰ http://observator.org.al/wp-content/uploads/2015/03/2015Martesat_e_hershme_ne_Shqiperi.pdf

⁴¹ Sistemi i mbrojtjes së fëmijëve Shqiptare ka nevojë të reflektojë fenomenin e martesave të hershme. Ka akoma një mungesë të sistemit të referimit për identifikimin e rasteve të fëmijëve të martuar, kështu që institucionet duhet të punojnë akoma për të ndërtuar një sistem referimi për martesat e hershme.

⁴² UNICEF (2014), Mbrojtja e Fëmijëve nga dhuna, përdhunimi dhe abuzimi – Martesat e hershme

⁴³ Referuar shkresës nr.110/1 prot., datë 1.7.2020, Kryetari i Bashkisë Fier, ka informuar se rasti i të miturës 13 vjeçare është trajtuar prej tyre. Nga ana e NJMF, është mbështetur nëna e mitur, me asistencë psikologjike, ligjore, ndihma me paketa ushqimore, si dhe kanë ndihmuar edhe për procesin e regjistrimit të fëmijës në gjendjen civile. Tashmë ky rast po vijon trajtimin dhe monitorimin nga ana e NJMF, në Bashkinë Fier.

Rome dhe Egjiptiane dhe masat e marra për sigurimin dhe plotësimin e nevojave të tyre bazike të jetesës, në këtë situatë të paprecedentë. Realiteti i përditshëm, na ka bërë të reflektojmë thellë dhe të kuptojmë se Romët (pa përjashtuar këtu edhe Egjiptianët), sot janë një grup vulnerabël dhe në risk, sikurse edhe disa kategori të tjera sociale në vend. Dhe, kur flasim për këtë sistem, kemi parasysh strehimin, regjistrimin në gjendjen civile, përfitimin e ndihmës ekonomike, apo edhe arsimimin, si problemet më kyçe, pa përjashtuar këtu punësimin, formimin profesional, kujdesin shëndetësor dhe çdo benefit, që sistemi ynë shoqëror ua siguron qytetarëve të vet. Pikërisht për këtë fakt, sot është koha për të folur me gjuhën e më të dobët, për të gjetur një zgjidhje, e cila i integron natyrshëm këto minoritete, që janë në këtë gjendje të vështirë. Ky ka qenë dhe është, vizioni i institucionit të Avokatit të Popullit ndaj këtyre problematikave shqetësuese. Gjendja e tyre aktuale, si të pastrehë, të papunë dhe pa shërbime jetësore, rrit dhe përkeqëson edhe më tej gjendjen e këtyre komuniteteve, e të gjitha këto pasoja nuk cenojnë vetëm këto komunitete, por shkaktojnë efekte negative tek fëmijët, duke passjellë edhe martesat në moshë të hershme.

Sot, nevojitet një vëmendje e angazhim institucional i shtuar, për t'ju përgjigjur nevojave bazike të jetesës së këtyre komuniteteve, e konkretizuar me masa që ndikojnë drejtëpërdrejtë dhe që sigurojnë një standard të pranueshëm jetese në kushtet edhe të kësaj pandemie globale. Ofrimi i ndihmës financiare shtesë, i mjeteve bazë të jetesës, garantimi i ofrimit të shërbimeve bazë sociale dhe aksesit në këto shërbime për këto komunitete, janë disa nga sugjerimet e institucionit të Avokatit të Popullit për këto komunitete. Problemet e Romëve dhe Egjiptianëve sot në Shqipëri, nuk janë thjesht e vetëm probleme të tyre, por një kampanë e fortë për të gjithë shoqërinë shqiptare, andaj zgjidhja e tyre është në të mirë të shoqërisë sonë. Askush nuk duhet të lihet mbrapa në këtë situatë të pazakontë, që kërkon ndërveprim, mbështetje dhe solidarizim shoqëror.

Në përfundim, mbrojtja e fëmijëve është komponent i secilit nga Objektivat e Mijëvjeçarit për Zhvillim të Qëndrueshëm. Një mjedis mbrojtës, që përfshin të gjitha fushat e jetës shoqërore, ku ligjet, shërbimet, sjelljet dhe praktikat zvogëlojnë rreziqet me të cilat përballen fëmijët, mund të parandalojë ndodhinë e shumë formave të dhunës, shfrytëzimit dhe abuzimit ndaj fëmijëve. Periudha e pandemisë COVID-19 dhe kriza globale e shëndetit, i ka lënë shumë fëmijë jashtë shkollës dhe presionet ekonomike ndaj familjeve vazhdojnë të rriten.

Por, ndërsa Kodi i Familjes vendos një kufi moshe për lidhjen e martesës (18 vjeç) dhe i njej diskrecionin gjykatës, që për shkaqe me rëndësi, të lejojë lidhjen e martesës përpara kësaj moshe, është i paqartë dhe nuk përcakton, se

deri ku do të shtrihet kjo tolerancë moshe, për shkaqe me rëndësi. Legjislacioni për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës parasheh, se “...realizimi dhe mbrojtja e të drejtave të fëmijëve mbështetet në një nga parimet kryesore, që Konventa e OKB-së dhe ky ligj parashohin, atë të respektimit të dinjitetit, nderit dhe personalitetit të fëmijës, duke garantuar kështu, zhvillim të qëndrueshëm fizik, mendor, moral, shpirtëror e social..”⁴⁴. Realizimi në praktikë i këtij parimi nga ana e autoriteteve shtetërore përgjegjëse, do të thotë ofrimi i mbrojtjes për fëmijët nga çdo lloj forme dhune, duke i ofruar mbrojtje.

Aktualisht, pranohet gjegjësisht, se martesat e parakohshme dhe e detyruar me të mitur, janë praktika të dëmshme në shkelje të të drejtave të njeriut dhe, nxisin vazhdimin e praktikave të tjera të dëmshme dhe shkeljeve të të drejtave të njeriut. Martesa e detyruar dhe e hershme e individit përbën shkelje të nenit 24 (3) të Konventës së OKB-së për të drejtat e fëmijëve, nenit 16 (2) të Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave, nenit 16 (2) të Deklaratës Universale të Njeriut për Drejtat e Njeriut, nenit 23 (3) të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, si dhe nenit 10 (1) të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore.

Avokati i Popullit është një nga aktorët e angazhuar në mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut, të cilat përbëjnë edhe bazën e konceptimit të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm. Në vazhden e rekomandimeve të mëparshme, sjellim në vëmendje, se kemi rekomanduar monitorimin në vijimësi të punës së strukturave shtetërore përgjegjëse, sipas legjislacionit në fuqi dhe marrjen e masave konkrete nga Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, për vendosjen dhe ekzekutimin e sanksioneve administrative, në rast të mospërbushjes së detyrimeve ligjore nga këto struktura.

Në funksion të përbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, për garantimin me efektivitet të ushtrimit, respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijës në interesin më të lartë të tyre, në zbatim të legjislacionit dhe të instrumenteve ndërkombëtare, bazuar edhe në Deklaratën e Meridës “Mbi rolin e institucioneve të të drejtave të njeriut në Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm”, si dhe të rolit specifik në procesin e zbatimit dhe monitorimit të Agjendës 2030 të Kombeve të Bashkuara, të cilat synojnë edhe eliminimin e martesave të hershme ose të detyruara të fëmijëve deri në vitin 2030, vlerëson domosdoshmërinë e ndryshimeve në Kodin e Familjes.

⁴⁴ Pika 2, e nenit 6, të ligjit nr.18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”.

Institucioni i Avokati i Popullit, në mbështetje të nenit 24, të ligjit nr.8454, datë 4.2.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar,

REKOMANDON:

- Marrjen e masave, për vlerësimin e ndryshimeve në ligjin nr.9062, datë 8.5.2003 “Kodi i Familjes”, të ndryshuar me qëllimin e parandalimit të martesave të fëmijëve, nisur nga mbrojtja e interesit të tyre më të lartë.
- Marrjen e masave, për shfuqizimin e pikës 2, të nenit 7, të Kodit të Familjes (që u njeh të drejtën gjykatave të miratojnë martesat nën moshën 18 vjeç) dhe rikonceptimin e një dispozite, që përcakton moshën minimale, nën të cilën nuk lejohen përjashtime nga mosha ligjore për t’u martuar, detyrim ky, që buron edhe nga Konventa e OKB-së për të drejtat e fëmijëve.
- Marrjen e masave, për përfshirjen në Planin e Ardhshëm Kombëtar të Veprimit për të Drejtat e Fëmijëve, të ndërgjegjësimit, lidhur me pasojat e dukurisë së martesave nën moshë të fëmijëve, në mënyrë që problematika të adresohet e integruar dhe gjithëpërfshirëse. Ndërgjegjësimi për pasojat e martesave të hershme duhet të rritet gjithashtu, midis prindërve, fëmijëve dhe të rinjve, që jetojnë brenda komuniteteve, ku martesat e fëmijëve praktikohet gjerësisht. Përpjekjet për t’i dhënë fund martesës së fëmijëve duhet të synojnë në veprime të koordinuara e të buxhetuara në nivel multisektorial në arsim, shëndetësi, mbrojtje dhe sektorë të tjerë.

Në mbështetje të nenit 22, të ligjit nr. 8454 datë 4. 2.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, organet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandime, duhet t’i shqyrtojnë ato dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit.

Duke Ju falënderuar për mirëkuptimin dhe, në vijim të bashkëpunimit, ndërmjet institucioneve tona, në frymën e legjislacionit të mbrojtjes së fëmijës, drejt qasjes së bashkërendimit dhe koordinimit ndërsektorial, si dhe në funksion të përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, për garantimin me efektivitet të ushtrimit, respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijës, lutemi shqyrtimin e këtij rekomandimi.

K O M I S I O N E R

Nejla PEKA